

KOSOVO



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

09.09.2022, Prishtinë

Bazuar në Ligjin e Punës së Republikës së Kosovës si dhe rregulloret të brendshme të punës së Komitetit Olimpik të Kosovës (Punëdhënës) shpallim këtë:

K O N K U R S

Pozita: Zyrtar/e për Marketing;

Periudha: Një (1) vjeçare me mundësi vazhdimi;

Vendi i punës: Prishtinë;

Orari i Punës: 8 orë në ditë, respektivisht 40 orë në javë;

Punëdhënësi: Komiteti Olimpik i Kosovës;

Raporton: Sekretari i Përgjithshëm dhe Bordi Ekzekutiv i KOK;

Qëllimi i vendit të punës:

Punëdhënësi po kërkon një person ambicioz dhe të motivuar për ta zhvilluar strategjinë tonë të marketingut dhe për ta krijuar një rrjetë të klientëve dhe sponsorëve të mundshëm për të na ndihmuar që ta zgjerojmë tutje praninë tonë online dhe offline.

Kjo është mundësi ideale për dikë që dëshiron t'i sjell sjellë aftësitë, idetë dhe energjinë e marketingut në një Organizatë Sportive si e jona. Në këtë pozitë do të punohet për së afërmi me të gjitha departamentet e organizatës tone e cila po rritet dita-ditës, prandaj, teksa kryen detyra tjera, duhet të jesh gati ta përvetësosh informacionin në mënyrë të saktë dhe efikase.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Angazhimin në përmirësimin dhe krijimin e planit strategjik të marketingut dhe shitjeve të Punëdhënësit, përfshirë këtu, por pa u kufizuar në: reklamat në internet, shitjen e revistave të shtypura, sponsorizimet, etj.

- Mbikëqyrja e webfaqes së Punëdhënësit dhe platformave të mediave sociale përmes reklamave tradicionale dhe mundësive të tjera në internet (online).
- Identifikimin e burimeve të reja të mbështetjes financiare nga individët dhe bizneset private, duke përfshirë kontaktimin e reklamuesve të mundshëm, mbledhjen dhe shqyrtimin e ofertave, lidhjen e kontratave, etj.
- Mbajtjen e të dhënave të shitjeve, mirëmbajtjen e inventarit të materialeve promovuese, planifikimet e takimeve dhe ngjarjeve për shitje, mirëmbajtjen e databazave dhe përgatitjen e raporteve.
- Përgatitjen e planeve strategjike të marketingut, duke përfshirë objektivat dhe treguesit kryesorë të performancës së Organizatës;

Njohuritë,shkathësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

- Njohuri të shkëlqyera e gjithëpërfshirëse profesionale nga fusha e marketingut;
- Njohuri e gjuhës angleze;
- Njohuri me aftësi të mira të punës me kompjuter me aplikim të programeve (Microsoft Word,Exel,Power Point etj);
- Të paktën dy vite përvojë pune në marketing dhe shitje;
- Aftësi të mira të punës ekipore;
- Diploma në Marketing apo fushat tjera të ngjashme është përparësi.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë universitare, Drejtimi Marketing.

Përvoja e Punës:

2 vite përvojë pune profesionale.

Konkursi është i hapur 10 ditë kalendarike nga dita e publikimit duke filluar nga data 09.09.2022 deri me datë 22.09.2022 si datë e mbylljes së konkursit.

Paraqitja e kërkesave:

Të aplikohet duke dërguar CV, letër motivuese dhe referenca përkatëse në emailin: legal@noc-kosovo.org me përshkrimin: *Aplikim pune – Zyrtar/e për Marketing;*